

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigje ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	04.01.2024	Kërkesë për informacion nga A.K. në lidhje mbi numrin e çështjeve të shortuara në rrugë manual, kur sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk ka funksionuar që i përket periudhës nga vitit 2018 deri në datën 22.12.2023.	09.01.2024	Nga verifikimet e kryera rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk ka raste të çështjeve të shortuara në rrugë manuale, kur sistemi i menaxhimit të çështjeve nuk ka funksionuar, për periudhen nga viti 2018 deri në datën 22.12.2023.	E plotë	S'ka
2.	09.01.2024	Kërkesë për informacion nga B.B. në lidhje mbi numrin e padive gjyqësore me palë gazetarët ose punonjësit e medias për periudhen janar 2023-dhjetor 2023 si dhe stadin e shqyrtimit të tyre.	12.01.2024	Nga verifikimet e kryera rezulton 1(një) çështje civile me palë paditëse A.D. dhe palë e paditur Emisioni Piranjat pranë Syri television. Në lidhje me statusin e çështjes ju bëjmë me dije se është në fazën e gjykimit, nuk rezulton se ka datë të planifikuar për këtë çështje.		
3.	14.01.2024	Kërkesë për informacion nga E.H. me profesion gazetar, për të dhëna statistikore bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj informacion si më poshtë: 1.Sa urdhëra mbrojtjes janë lëshuar nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, gjatë tre viteve të fundit, të ndara sipas viteve 2021, 2022, 2023? 2.Sa çështje të dhunës së familjes	23.01.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 14.01.2024 e paraqitur në formë elektronike, në bazë të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” me anë të cilës kërkoni informacion ju informojmë si më poshtë: Në lidhje me pikën e parë ku kërkoni sa është numri i urdhrave të mbrojtjes që janë lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm	E plotë	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		janë gjykuar gjatë tre viteve të fundit, të ndara sipas viteve 2021, 2022, 2023?		<p>Lezhë, ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra në të dhëna statistikore rezulton se pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë lëshuar 101 (njëqind e një) urdhra mbrojtje për vitin 2021, 95 (nëntëdhjetë e pesë) urdhra mbrojtje për vitin 2022 dhe 99 (nëntëdhjetë e nëntë) urdhra mbrojtje për vitin 2023.</p> <p>Në lidhje me pikën e dytë ku kërkoni sa është numri i çështjeve të gjykuara me objekt dhunë në familje, ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra në të dhëna statistikore rezulton se pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë gjykuar 37 (tridhjetë e shtatë) çështje me objekt dhunë familje për vitin 2021, 26 (njëzet e gjashtë) çështje me objekt dhunë familje për vitin 2022 dhe 38 (tridhjetë e tetë) çështje me objekt dhunë familje për vitin 2023.</p>		
4.	29.01.2024	Kërkesë për informacion nga E.H. me profesion gazetar, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”, kërkoi informacion si më poshtë: Kërkoj dispozitivin e vendimit të dhënë nga Gjykata e Juridiksionit të	09.02.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 29.01.2024 e paraqitur në formë elektronike, në bazë të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” me anë të cilës kërkoni informacion në lidhje me dispozitivin e vendimit të dhënë	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		Përgjithshem Lezhë, për pezullimin nga detyra të Drejtorit të Agjensisë së Kadastres në Lezhë, G. M. dhe punonjësve të tjerë të këtij institucioni.		nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për pezullimin nga detyra të Drejtorit të Agjensisë së Kadastres Lezhe G.M. dhe punonjësve të tjerë të këtij institucioni ju informojmë se: Sa më sipër, në këto kushte duke qënë se kërkesa juaj lidhet me fazën e hetimeve paraprake (mund të përmbajë/konsiderohet sekret hetimor referuar përcaktimeve të Kodit të Procedures Penale) duke patur në konsideratë dhe faktin se çështja është zhvilluar me dyer të mbyllura, nuk mund të vendoset në dispozicion dispozitivi i vendimit penal i kërkuar nga ana juaj.		
5.	07.02.2024	Kërkesë për informacion nga.M.R., bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj informacion si më poshtë: Sa është numri i çështjeve në të cilat Gjykata e Lezhës ka lejuar martesën e një shtetasi të mitur, nën moshën 18 vjeç, në zbatim të nenit 7 të Kodit të Familjes, gjatë viteve 2017-2023? Sa prej tyre janë meshkuj dhe sa janë femra?	16.02.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj e datës 07.02.2024 e depozituar në mënyrë elektronike, ju informojmë se pas verifikimeve të kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, rezulton se gjatë viteve 2017-2023, janë dhënë 3(tre) vendime gjyqësore me palë kërkuese femrat dhe (0) zero me pale kërkuese meshkuj me objektin e kërkuar nga ana juaj.	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

6.	12.02.2024	Kërkesë për informcion nga S.K. me profesion gazetar, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj të vendosni në dispozicion vendimet penale dhe civile të dhëna nga kjo Gjykatë për shtetasin A.Ç për periudhën 2004-2018.	12.02.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 12.02.2024 e paraqitur në formë elektronike, ku kërkonti vendimet penale dhe civile të dhënë nga kjo Gjykatë për shtetasin A.Ç kërkesë kjo e bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” ju informojmë si më poshtë, Sa më sipër bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ky vendim ju dërgohet në formë të anonimizuar me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale të cilat ndodhen të përshkruara në vendimin e mësipërme.	E plotë	S’ka
7.	21.02.2024	Kërkesë për informcion nga S.K. me profesion gazetar, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj të vendosni në dispozicion vendimet penale dhe civile të dhëna nga kjo Gjykatë ose ish-Gjykata Kurbin për shtetasit A.Ç, A.Ç, K.Ç, I.Ç, S.T.	29.02.2024	Në vijim të kërkesës tuaj të datës 21.02.2024 e paraqitur në formë elektronike, ku kërkonti vendimet penale dhe civile të dhënë nga kjo Gjykatë ose ish-Gjykata e Kurbin për shtetasit A.Ç., A.Ç, K.Ç, I.Ç, S.T., kërkesë e bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” ju informojmë se nga Zyra e Shërbimit Kurbin janë dërguar vendimet e mësipërme. Sa më sipër bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				mbrojtjen e të dhënave personale” vendimet gjyqësore bashkëngjitur ju dërgohen në formë të anonimizuar me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale te cilat ndodhen të përshkruara në vendimet e mësipërme.		
8.	05.03.2024	<p>Kërkesë për informacion nga E.K. me profesion gazetar, për të dhëna statistikore bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkoj informacion si më poshtë:</p> <p>1. Sa kërkesa për “Urdhër Mbrojtjeje” janë depozituar pranë Gjykatës Lezhë për vitin 2022, 2023, 2024 (janar- shkurt) nga vajzat dhe gratë?</p> <p>2. Sa prej këtyre rasteve janë pranuar nga Gjykata, sa janë pushuar dhe sa janë rrëzuar? Ju lutem, specifikoni shifrat për secilin vit të kërkuar.</p> <p>3. Sa është numri i rasteve për “Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje” të ardhura pranë Gjykatës Lezhë për vitin 2022, 2023 dhe 2024 (janar-shkurt) nga vajzat dhe gratë?</p> <p>4. Sa prej këtyre rasteve janë pranuar nga Gjykata, sa janë pushuar dhe sa janë rrëzuar? Specifikoni shifrat për secilin vit të</p>	12.03.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 05.03.2024 e paraqitur në formë elektronike, në bazë të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” me anë të cilës kërkon informacion ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Për vitin 2022 janë depozituar nga vajzat dhe gratë 10 (dhjetë) Urdhëra Mbrojtje dhe nga këto 10 janë pranuar nga gjykata. (Janar-Shkurt).</p> <p>Për vitin 2022 janë depozituar nga vajzat dhe gratë 3 Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje nga të cilat 3 janë pranuar nga gjykata (Janar-Shkurt).</p> <p>Për vitin 2023 janë depozituar nga vajzat dhe gratë 5 (pesë) Urdhëra Mbrojtje dhe nga këto 4 janë pranim dhe 1 është pushim (Janar-Shkurt).</p> <p>Për vitin 2023 është depozituar nga vajzat dhe gratë 1 (një) Urdhër i Menjëhershëm i Mbrojtjes dhe është vendosur pushim nga gjykata. (Janar-</p>	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		kërkuar.		Shkurt). Për vitin 2024 jane depozituar nga vajzat dhe gratë 8 (tetë) Urdhëra Mbrojtje dhe nga këto 1 është pranim, 1 është rrëzim dhe 6 janë pushim (Janar-Shkurt). Për vitin 2024 janë depozituar nga vajzat dhe gratë 6 (gjashtë) Urdhëra të Menjëhershëm të Mbrojtjes nga të cilat 5 janë pranim dhe 1 është pushim (Janar-Shkurt).		
9.	08.03.2024	Kërkesë për informacion nga A.O. në lidhje me nëse në fashikullin gjyqësor të vendimit nr.138 datë 17.05.1991 ndodhet i administruar ndonjë dokumentacion tekniko-ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore përkatëse të kohës që ka të bëjë me të drejta përdorimi ose pronësie të banesës bashkëshortore të prindërve të mi.	18.03.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 08.03.2024 e paraqitur në formë elektronike, në bazë të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” me anë të cilës kërkoni informacion ju informojmë si më poshtë: Mund të paraqiteni pranë sportelit të arkivit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për tu njohur me aktet dhe verifikuar në qoftë se akti i kërkuar nga ana juaj ndodhet në dosjen gjyqësore me nr.vendimi 138 datë 17.05.1991.	E plotë	S’ka
10.	20.03.2024	Kërkesë për informacion nga Media “Investigative Network Albania”, bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", 1. Kërkojmë të dhënat e gjithë çështjeve gjyqësore në Gjykatën e	02.04.2024	Në lidhje me kërkesën tuaj të datës 20.03.2024 paraqitur në formë elektronike, në bazë të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” me anë të së cilës kërkoni	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		<p>Lezhës për z. A. Xh. dhe M. N., duke specifikuar numrin dhe datën e procesit penal, veprën penale për të cilën është procesi penal si dhe statusin aktual. 2. Kopje të vendimeve penale (përfundimtare, masa sigurie, pushimeve) për z. A., Xh. dhe M. N. 3. Kopje të vendimeve gjyqësore për sekuestrim të pasurive në emër të shtetasit A, Xh. dhe M. N.</p>		<p>informacion dhe dokumentacion ju informojmë si më poshtë: 1.Bashkëlidhur ju dërgojmë vendimin nr.344 datë 05.11.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në emër të shtetases M. N. e bija e N., e datëlindjes 13.05.1987 (ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.206 datë 15.09.2022 ka vendosur “Prishjen e vendimit tëGjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në atë Gjykatë, me trup tjetër gjykues”.) 2.Vendimin nr.125 datë 26.03.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në emër të shtetasit A. N. i biri i N. I datëlindjes 14.10.1974 (ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim dhe dosja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë). 3.Nga verifikimet e kryera në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për shtetasin me te dhënat e paraqitura nga ana juaj z.Xh. N. nuk rezulton ndonjë vendim penal në emër të tij. Sa më sipër bazuar</p>		
--	--	---	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” vendimet bashkëngjitur ju dërgohen në formë të anonimizuar me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale të cilat ndodhen të përshkruara në vendimet e mësipërme.		
11.						
12.						
13.						
14.						
15.						
16.						
17.						
18.						
19.						
20.						

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

² Data e regjistrimit të kërkesës.

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

⁴ Data e kthimit të përgjigjës.

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

⁶ Përgjigja jepet E plotë / E kufizuar / E Refuzuar / E deleguar.

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.